



## HISTORI SUKSESI

Në kuadër të procesit advokues në zbatim të rekomandimeve të Grupit të Ekspertëve GREVIO, QDNJD, si një anëtare aktive e Rrjetit të Monitorimit kundër Dhunës me bazë Gjinore ka ndjekur me vëmendje situatën e aksesit në drejtësi të viktimave të dhunës me bazë gjinore pas hyrjes në fuqi të hartës së re gjyqësore – zbatimi i së cilës nxjerr në pah një sërë problematikash që lidhen me nevojën për përfaqësim ligjor të viktimave (edhe në mungesë të tyre), pasi ato përballen me një sërë vështirësish dhe pasojash për shkak të largësisë së gjykatave nga vendbanimi i tyre si dhe përfshirjen e të miturve, viktimave të dhunës së asistuar në Kërkesë -Paditë me objekt lëshimin e UMM/UM.

Lidhur me keto çështje, QDNJD bazuar në një plan të mirë-organizuar advokimi ka zhvilluar takime me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe ka hartuar dy shkresa drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor të fokusuara në frymën e zbatimit të legjislacionit kundër dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, bazuar në standartet ndërkombëtare që burojnë nga Konventa e Stambollit, e ratifikuar nga shteti shqiptar.

KL Gj na ka informuar se adresimi efektiv i këtyre dy çështjeve i është kërkuar “*për mbajtje në vëmendje*” 13 (trembëdhjetë) Gjykatave të Shkallës së Parë. Specifikisht është kërkuar marrja e masave të nevojshme për adresimin e këtyre çështjeve, duke udhëzuar gjykatat që të shqyrtojnë çështjet që lidhen me dhunën në familje edhe në mungesë të viktimave.

Nga policia e shtetit QDNJD ka kërkuar vëmendje në përfshirjen e të miturve, viktimave të dhunës së asistuar në Kërkesë -Paditë me objekt lëshimin e UMM/UM, si edhe mbrojtja efektive nga dhuna në familje ushtruar ndaj të miturve në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të asistuar.

Në vazhdimësi, QDNJD do të monitorojë zbatimin e këtyre çështjeve nga institucionet përkatëse.

Advokimi u krye nga organizata Të Drejtat e Njeriut në Demokraci, organizatë anëtare e Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore, në kuadrin e punës për zbatimin e rekomandimeve të Grupit të Ekspertëve GREVIO për Shqipërinë, në zbatim të projektit “Fuqizimi i Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore drejt realizimit progresiv të Agjendës normative të barazisë gjinore përmes përdorimit të standardeve ndërkombëtare të Konventës CEDAW dhe Konventës së Stambollit”, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj Grave” i financuar nga Qeveria e Suedisë dhe zbatuar nga tre agjencitë e UN, UN Women, UNDP dhe UNFPA.